

VENDIM
Nr. 367, datë 11.6.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1701, DATË 17.12.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E DHËNIES SË AUTORIZIMEVE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË REJA GJENERUESE TË ENERGJISË, QË NUK JANË OBJEKT KONCESIONI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 34/1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregulloren “Për procedurat e dhënies së autorizimeve për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë, që nuk janë objekt koncesioni”, të miratuar me vendimin nr. 1701, datë 17.12.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 të nenit 2, fjalët “... dhe që lidhen me rrjetet e transmetimit dhe/ose shpërndarjes ...” shfuqizohen.

2. Pika 1 e nenit 4 të rregullores ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Çdo person që zhvillon veprimtari tregtare sipas legjislacionit shqiptar, duke përfshirë edhe shoqëritë tregtare të kontrolluara nga shteti, mund të aplikojë për marrjen e një autorizimi për ndërtimin e burimeve të reja gjeneruese.”.

3. Pas pikës 1 të nenit 18 shtohet pika 2, me këtë përmbajtje:

“2. Përmbushja e kushtit të përcaktuar në shkronjën “m” të pikës 1 nuk është e nevojshme, në rastin kur aplikimi për ndërtimin e një burimi gjenerues bëhet nga një shoqëri tregtare e kontrolluar nga shteti, e cila do ta përdorë energjinë e prodhuar për plotësimin e nevojave të veta.”.

4. Në nenin 20 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) miratimin e OST-së ose OSSH-së për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes sipas kërkesave të kodit të transmetimit ose shpërndarjes, për rastet kur burimi parashikohet të lidhet me rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes.”.

b) Shkronja “e” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“e) lejet dhe autorizimet mjedisore nga institucionet përgjegjëse vendore ose kombëtare, për rastet kur përmbushja e këtij kushti kërkohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.”.

c) Shkronja “f” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“f) dokumentacionin ligjor, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, që provon marrëdhënien afatgjatë mbi truallin që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues.”.

5. Në nenin 22 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) afatin e ndërtimit të burimit gjenerues.”.

b) Në shkronjën “e”, fjalët “...studimit të...” shfuqizohen.

c) Në fillim të shkronjës “j” shtohen fjalët “Përveç rasteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 18 ...”.

ç) Pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l”, me këtë përmbajtje:

“l) afatin maksimal të shfrytëzimit të burimit gjenerues.”.

Ngarkohet ministri i Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama